

DËSHMORËT E GREIKOCIT

Revistë e SHFMU «Dëshmorët e Greikocit» - Greikoc

Nr. 13- Prill 2018 - Greikoc

Urime 5 Prilli - Dita e shkollës!



NXËNËS TË DALLUAR TË SHKOLLËS SONË

DASHURIA PËR PUNËN E MJEKUT



Ari Zenelaj nxënësi simpatik i parashkollorës, shumë i talentuar për moshën që ka. Është e çuditshme, ndonjëherë njeriu ndryshon mendim e bashkë me të edhe ëndrrat e tij. Mirëpo, Ari ynë që moti ka këmbëngulur për ëndrrën e tij. Është ajo ëndërr në sirtar e vetmja, për të cilën nuk do të heq dorë, që beson se do ta bënte të plotësuar e ajo është të bëhet një mjek i suksesshëm, të punojë me plot përkushtim në këtë aspekt. Urojmë që Ari të realizojë ëndrrën e tij!

GJUHA SHQIPE - LËNDA QË MË PËLQEN

Quhet Arnita Kicaj, nxënëse e klasës IV₂, te mësuesja, Razë Spahiu. I pëlqejnë të gjitha lëndët, por më e preferuara e saj është gjuha shqipe. Hobi i saj është leximi. Duke u frymëzuar nga mësuesja e saj, ajo si profesion ka zgjedhur që të bëhet një mësuese, profesion nga i cili nuk do të heq dorë. Shumë suksese Arnita!



MËSUESIA - PROFESION ME VLERË



Urata Tafaj është nxënëse e klasës I₂, te mësuesja Dafinë Demaj. Ajo është aktive dhe e talentuar në të gjitha lëndët. Meqenëse, profesioni i mësuesit është një nga profesionet më të vlerësuara dhe më të respektuara në të gjithë botën, edhe Urata ka zgjedhur, që në të ardhmen të bëhet një mësuese e shkëlqyer. Asaj i urojmë që ëndrra t'i bëhet realitet!

NXËNËSJA QË PËLQEN LEXIMIN



Blenera Kurtishaj është nxënëse e klasës I₁, te mësuesja Pranvera Selimi. Të gjitha lëndët i mëson me shumë dashuri. Hobi ka leximin. Leximi për të është burim i dijes. Blenera ëndërron të bëhet një mjeke dhe të shpëtojë mijëra jetë! Si optimiste mbetet në pritje të realizimit të ëndrrës!

DËSHIROJ TË BËHEM MJEKE!



Elona Beqiraj, nxënëse e klasës V₂ te mësuesja Sevdie Lushaj, një nxënëse shembullore në çdo aspekt. Njeriu është qenia më inteligjente në planet, këtë e them, sepse ne si qenie kemi ëndërra për të ardhmen. Edhe Elona ka një ëndërr e ëndërra e saj është të bëhet një mjeke. Ajo thotë: "E di që është pak rrugë e gjatë dhe, ndoshta, pa krye, por jo e pamundur".

Elonës i urojmë suksese në realizimin e ëndrrës!

MATEMATIKA - MBRETËRESHA E LËNDËVE

Nxënësjë e klasës V₁, Njomza Tafaj është një nxënëse për admirim, shembullore në të gjitha lëndët. Lënda që i fle në zemër është matematika. Edhe mësuesja e saj, Besa Beqiraj është krenare për të, duke theksuar se është një nxënëse e kompletuar. Njomza matematikën e konsideron mbretëreshë të lëndëve.




NJË PEDIATRE E PËRKUSHTUAR




Quhem Sumeja Kicaj, nxënëse e klasës II₂ te mësuesi Sami Baraliu. Ajo është nxënëse e dalluar, shembull për klasën, duke treguar talent, përkushtim për të gjitha lëndët. Se çfarë dëshiron të bëhet në të ardhmen, ajo na u përgjigj: "Kam dëshirë të bëhem mjeke për fëmijët. Gjithmonë dëshiroj t'iu ndihmoj fëmijëve. Është aq e bukur të ndihmosh krijesa aq të vogla e të ëmbla dhe kjo më shtyn të bëhem pediatre". Suksese Sumeja!

AVOKATJA E ARDHSHE



Nxënësjë e dalluar e klasës IV₁ është Eriola Beqiraj te mësuesja, Elhame Zenelaj. Ajo dallohet për nga zgjuarsia, si dhe mënyra e interpretimit dhe zgjedhjes së fjalëve. Mësuesja për të flet fjalë miradije. Eriola dëshiron që të bëhet një avokate, ka një mision të mrekullueshëm: të mbrojtë të drejtat dhe liritë e shtetasve. Suksese Eriola!


ARKITEKTURA PROFESION I BUKUR



Merlind Kicaj nxënësi i klasës III₂, vijon mësimet te mësuesi Haki Haziraj. Është i suksesshëm në të gjitha aspektet. Synimi i tij është që në të ardhmen të bëhet një arkitekt i njohur, të projektojë shtëpi shëndeti, shkolla etj. Sukes Merlind!

PROFESIONI I MJEKUT

Dorart Shahinaj nxënësi i klasës II₁, te mësuesi Fikret Ramaj. Nxënës i dalluar për suksesin dhe sjelljet e tij shembullore. Ai e falënderon mësuesin për punën e palodhshme, si dhe përkushtimin që ka ai për nxënësit. Dorarti është shumë human, andaj si ëndërr ka përzgjedhur të bëhet mjek, t'iu ndihmojë njerëzve në shërimin e sëmundjeve të ndryshme. I urojmë shumë suksese atij!



Përgatiti: Sevdie LUSHAJ



DËSHMORËT E GREIKOCIT

Revistë e shkollës fillore
dhe të mesme të ulët
“Dëshmorët e Greikocit”

BOTUES:

Këshilli i shkollës

REDAKTOR PËRGJEGJËS:

Fikret RAMAJ

KOLEGJUMI I REDAKSISË:

Tahir ZENELAJ

Merita KUKAJ

Besa BEQIRAJ

Sevdie LUSHAJ

BASHKËPUNËTORËT:

Hashim KUKAJ

Besim HALITAJ

Sedat SELIMI, Zvicër

Nasuf KRASNIQI

Elhame ZENELAJ

Ardhmërie BARALIU

Gani KICAJ

Fahri KUKAJ

Shkëndije KICAJ, nxënëse

Elmedina CANAJ, nxënëse

Erbilin KURTISHAJ, nxënëse

Sara KICAJ, nxënëse

KORREKTORE:

Zelie LUSHAJ

SEKRETAR I REDAKSISË:

Sami BARALIU

BALLINËN E PUNOI:

Artan BEQIRAJ, dizajner grafik

Realizimi kompjuterik
në redaksinë e revistës “FIDANT”
Dorëshkrimet dhe foto nuk kthehen.

HISTORIKU I REVISTËS “DËSHMORËT E GREIKOCIT ”

Historiku i revistës “Dëshmorët e Greikocit ”ka një rrugëtim të gjatë. Kjo revistë filloi të botohet gjatë viteve 93/94. Për vite të tëra, kjo revistë u bë strehë e gjithë atyre nxënësve, që kishin filluar t’i bënë hapat e parë në artin e të shkruarit, shkrime këto, me të cilat fillon rrugëtimi historik i kësaj reviste. Ishte një punë e mundimshme e mësuesve tanë, e në veçanti e mësuesit Fikret, të cilët për asnjë moment s’u ndalën, përkundër vështirësive që patën. Në këtë revistë u botuan shumë shkrime, poezi, tregime, ese, kujtime e gjithçka që lidhej me jetën shkollore të asaj kohe. Nga kjo revistë dolën emra të njohur, që do të lënë gjurmë në fushën e artit, por edhe të lëmenjve të tjerë. Gjatë viteve 98/99 për shkaqe politike revista “Aradha e Sharrit” e që tani mban emrin “Dëshmorët e Greikocit” e ndali botimin e saj. Ishte koha kur shqiptarët filluan t’i kërkonin të drejtat e tyre, për të qenë të lirë e të pavarur. Filloi një fushatë e egër ndaj profesorëve, studentëve dhe të gjithë atyre që mendonin ndryshe nga pushtuesit serb. U deshtë të presim 3 vjet që revista, sërish t’i kthehet jetës. Ajo u ringjall për ta vazhduar misionin e saj. Pas mbarimit të luftës, mësues e nxënës, sërish iu rrekën punës që këtë revistë t’ia kthejnë shkollës, aty edhe ku e kishte vendin, me bindjen se më nuk do ta ndalojë rrugëtimin e saj. Të bindur se nuk do të mungojë angazhimi i juaj në këtë aspekt, sepse revista “Dëshmorët e Greikocit” është jona. Përmes saj pasqyrohet puna jonë dhe aktivitetet në kuadër të shkollës.

Prandaj, sot të dashur lexues, në duart tona kemi numrin e trembëdhjetë me radhë të revistës sonë, e cila është bërë traditë të nxirret në prag të 5 Prillit-Ditës së shkollës dhe përvjetorit të dëshmorëve. Dëshmorët do t’i përkujtojmë gjithmonë me krenari, sepse ata ranë për të mos vdekur kurrë! Në fund falënderojmë të gjithë bashkëpunëtorët e revistës që me shkrimet e tyre e pasuruan këtë numër të revistës. Kolegë e nxënës të nderuar, urime Dita e Shkollës! Ditë më të mira na presin nga ky brez shembullor që po rritet!

Besa **BEQIRAJ**

FALËNDERIM

Drejtoria e shkollës, Këshilli i shkollës,
si dhe redaksia e revistës falënderon nga
zemra sponsorin gjeneral, Shoqatën
“Greikoci”, që na ndihmoi për nxjerrjen e
këtij numri.

**BREZAT QË DO TË VIJNË DO T'I MBAJNË
NË ZEMËR DËSHMORËT**



Jakup Kurtishaj



Hazir Selimaj



Avdyll Beqiraj



Haxhi Haxhaj



Sabit Lushaj

Ka vetëm një rrugë nëpër të cilën ecën historia e lirisë. Ajo është rruga e gjakut të dëshmorëve të kombit, të cilët në kthesën e madhe historike, ishin të gatshëm të falin gjakun për ardhjen e lirisë.

Kalojnë vite, kalojnë edhe shekuj e kujtimi për dëshmorët mbetet i freskët, prore në mendjet tona, në kujtesën tonë historike. Brezat që vijnë do t'i mbajnë në zemër dëshmorët, për t'i bërë ata flamuj në valim rrugëve e shesheve tona të Liria ndërtohet me jetëra, ndërtohet me gjak, ndërtohet me dëshmorë. Kurse, dëshmorët janë nderi dhe krenaria e popullit tonë martir. E atij populli që synon ta fitojë lirinë shekuj me radhë dhe që do e di ta ndërtojë lirinë.

Dëshmorët janë ndërgjegjja më sublime dhe vetëdija e ngritur me e lartë, deri në pedestalin e vetëflijimit.

Dëshmorët u ringjallën sot dhe festojnë bashkë me ne Lirinë. Dëshmorët janë ata që dhanë jetën për Liri. Sakrifikuan jetën e tyre, duke luftuar dhe duke derdhur gjak.

Në këtë 20 vjetor kujtojmë dëshmorët e fshatit tonë: **Jakup Kurtishaj, Hazir Selimaj, Avdyll Beqiraj, Haxhi Haxhaj, Sabit Lushaj, Zenel Curraj, Naser Tafaj dhe Safet Kicaj.**

Me vendim të Qeverisë së Kosovës, fshatit tonë iu shtuan edhe dy dëshmorë të kombit: **Nuhi e Fatmir Tafaj.** Tani fshati ynë numëron gjithsej 10 dëshmorë të kombit.

**! PËRJETSHËM QOFTË KUJTIMI PËR TA!
U QOFTË I LEHTË DHEUI KOSOVËS!**

Fikret RAMAJ



Zenel Curraj



Naser Tafaj



Safet Kicaj



Nuhi Tafaj



Fatmir Tafaj

NË FOKUS DO TË JETË MIRËMBAJTJA E FSHATIT GREIKOC

Hyrje

Para se të fillojmë raportimin e tretë për veprimtarinë e shoqatës „Greikoci“, shprehim falënderimet më të sinqerta për të gjithë anëtarët e saj, të cilët po e mundësojnë realizimin e të gjitha aksioneve të ndërmarra nga Shoqata jonë në aspektin financiar. Gjithashtu, ju urojmë të gjithë anëtarëve shëndet e fat në vitin e ardhshëm kalendarik!

Në mënyrë që projektet tona të jenë më të mëdha, si dhe të suksesshme, ju bëjmë thirrje të gjithë anëtarëve, që të kontribuojnë në rritjen e anëtarisë, pasi që ata janë mirë të informuar rreth aktiviteteve tona, si dhe mund të ndikojnë te ndonjë një mik apo dashamirë, duke e sensibilizuar rreth punës sonë.

Njëkohësisht, jeni të informuar që, edhe në Kosovë, prej këtij viti banorët e Greikocit mund të kontribuojnë me nga 20 euro për mirëmbajtjen e ambientit. Në këtë pikë, ne duam që të gjithë banorët t'i inkurajojmë që të japin kontributin e tyre për mirëmbajtjen e ambientit, pasi që të gjitha aktivitetet tona iu destinohen banorëve të Greikocit. Këto kontribute janë në të mirë të tyre. Shoqata „Greikoci“ kërkon nga të gjithë banorët e fshatit Greikoc: mirësjellje dhe përkrahje në mirëmbajtjen e ambientit.

Përkrahje për botimin e revistës „Dëshmorët e Greikocit“, nr.12 (prill 2017)

Siç jeni informuar në botimin e kaluar, shoqata „Greikoci“ ka vendosur që të jetë sponsor gjeneral i revistës „Dëshmorët e Greikocit“. Kjo revistë botohet çdo vit, në prill, për nder të dëshmorëve të fshatit të rënë në luftën e fundit në Kosovë në vitet 1998 dhe 1999.

Botues i revistës është Këshilli i shkollës. Revista përmban punime të ndryshme, si: poezi, vizatime, rrëfime apo intervista të nxënësve dhe të mësuesve të shkollës fillore të fshatit Greikoc.

Nr.13 - prill, 2018



Përkrahje për blerjen uniformave për korin e shkollës "Dëshmorët e Greikocit" (prill 2017)

Pas kërkesës së udhëheqësve të korit të shkollës fillore të Greikocit për t'i dalë në ndihmë, në aspektin financiar, për blerjen e uniformave të reja, shoqata „Greikoci“ vendosi në fillim të vitit, që kërkesës në fjalë t'i përgjigjet pozitivisht.



Mirëmbajtja e fshatit dhe aksioni i mbjelljes së blinjeve (prill 2017)

Në vitin e kaluar, shoqata „Greikoci“ zyrtarizoi punësimin e dy personave për mirëmbajtjen e ambientit të fshatit. Këta punëtorë janë përgjegjës për pastrimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve, hapjen e



varrezave, largimin e mbeturinave, pastrimin e përrënjeve etj. Në prill të këtij viti, pas një iniciative të Ramadan Haxhaj, Ramadan Canaj dhe Sedat Selimaj, punëtorët e shoqatës „Greikoci“ morën detyrën për mbjelljen dhe mirëmbajtjen e këtyre blinjve. Në këtë aksion u mbollën gjithsej 110 trupa të blirëve, ku u inkadruan edhe banorë të tjerë të fshatit. Shoqata „Greikoci“ falënderoi të gjithë kontribuesdhënësit në këtë aksion, si dhe inkurajoi banorët e fshatit, që të vazhdojnë më aksione të tilla.

Grill & takim (maj 2017)

Më 7 maj, ditë e diel, shoqata „Greikoci“ i ftoi anëtarët e saj (në kuadër të mbledhjes së anëtarisë) për një drekë. Ky takim u mbajt në Shtëpizën e Malit të komunës Birmenstorf të Aargaut. Morën pjesë mbi 40 pjesëmarrës. Në këtë takim, anëtarët u njoftuan rreth aktiviteteve dhe mjeteve financiare të Shoqatës për vitin 2016/2017.



Iftar për bashkëvendasit (qershor 2017)

Më 2 qershor, ditë e premte, shoqata „Greikoci“ (gjatë muajit të shenjtë të Ramazanit) i ftoi banorët e fshatit Greikoc për një iftar. Ky iftar u mbajt në oborrin e Xhamisë së Fshatit dhe kishte mbi 90 pjesëmarrës. Shoqata „Greikoci“ mbështet çdo aktivitet, ku ndodh grumbullimi i bashkëvendasve me synime për të ndryshuar shoqërinë për së miri.



Rreth shoqatës „Greikoci“:

Themelimi: 17 maj 2015
Selia: Ossingen ZH – Zvicër
Numri i anëtarëve: mbi 200
Kryetar: Rexhep Neziraj (+41 79 489 49 92)
Webfaqja: www.greikoci.ch
Kontakt: shoqata_greikoci@gmx.ch
Facebook: Shoqata Greikoci

Parku i fshatit „Dëshmorët“ (qershor - gusht 2017)

Pas vendimit të kryesisë së Shoqatës, për të ndërtuar një park publik për banorët e fshatit Greikoc, filluan edhe punimet në qershor të këtij viti. U përzgjedh edhe kompania për realizimin e këtij projekti. Po thuaj se gjatë të gjithë verës së këtij viti kishte aksione për të realizuar këtë projekt, ku u inkuadrua edhe komuna e Suharekës për realizimin e rrethojës së parkut, disa kompani, si dhe banorët e Greikocit. Më 6 gusht, shoqata „Greikoci“ në prani të banorëve të fshatit bëri edhe hapjen zyrtare të parkut të parë në fshatin Greikoc, i cili është emëruar „Dëshmorët“. Vlen të cekët që në këtë takim janë ndarë edhe mirënjohje për ata që kontribuan për realizimin e këtij projekti, si dhe për persona të tjerë, të cilët japin një kontribut të veçantë, që nga themelimi i Shoqatës, në vitin 2015.



Synimet për vitin 2018

Edhe për vitin 2018 fokus i Shoqatës do të jetë mirëmbajtja e fshatit Greikoc. Pas vërsimeve, në nëntor të vitit 2017 u dëshmua edhe njëherë se problem kryesor i fshatit Greikoc është kanalizimi dhe bllokimi i përrrenjve nga materiale të ndryshme. Kështu që, Shoqata edhe në të ardhmen do të vazhdojë me projekte sensibilizuese rreth mirëmbajtjes së ambientit në Greikoc, si dhe adresimin e këtyre problemeve tek autoritetet komunale të Suharekës. Projektet konkrete do të pasojnë gjatë pranverës së vitit 2018.

Sedat SELIMI

Dëshmorët e Greikocit

GREIKOCI FESTOI 10 - VJETORIN E PAVARËSISË SË KOSOVËS NË WETTINGEN TË ZVICRËS

Me rastin e 10 -vjetorit të Pavarësisë së Kosovës, më 17 shkurt 2018, „Shoqata Greikoci“, me seli në Ossingen ZH, organizoi një program festiv në restorantin “Winkelried” të Wettingenit, në nëkantonin Aargau-Zvicër.

Në këtë manifestim morën pjesë mbi 300 shqiptarë nga të gjitha trevat.

„Shoqata Greikoci“, në bashkëpunim me aktorin e mirënjohur, Adem Kicaj,



organizuan një program të pasur kulturor-artistik, ku morën pjesë këngëtarë të ndryshëm, si: Shpresim Veseli, Shqipdona Behluli, Jemin Lushaj, vëllezërit Kuçi (Arbnor dhe Rrezart), si dhe këngëtarët nga Greikoci, që udhëtuan special për këtë manifestim: Majlinda Kurtishaj dhe Florim Demaj.

Në shfaqjen humoristike, si mixha «Ibish», performoi artisti dhe regjisor i mirënjohur, Adem Kicaj.

Shoqata „Greikoci“

falënderoi të gjithë pjesëmarrësit, sponsorët, artistët, si dhe grupin e vallëzimit „Rinia“ nga Spreitenbachu, të cilët e hijeshuan me valle tradicionale shqiptare këtë manifestim.



NDJEJ KËNAQËSI KUR SHIKOJ SE SI ISH-NXËNËSIT E MI KANË ARRITUR SUKSESE NË SHKOLLIM

Sevdije Krasniqi u lind më 1979 në fshatin Savrovë. Ka mbaruar Fakultetin e Edukimit – Gjuhë dhe letërsi shqipe në Universitetin e Prishtinës – qendra në Prizren. Ka titullin bachelor. Në procesin mësimor ka filluar që të punojë që nga viti 2003. Ajo pa hezitim pranoi që t'i përgjigjet pyetjeve tona.

D. E GREIKOCIT: *Ju lutem për lexuesin e revistës sonë na jepni një lehtënjofitim të shkurtër?*

S. KRASNIQI: Jam Sevdije Krasniqi, administratore e shkollës “Dëshmorët e Greikocit”. Kam lindur në fshatin Savrovë më 4.3.1979. Jam e martuar dhe jetoj në fshatin Samadrexhë. Jam nënë e tre fëmijëve. Studimet i kam përfunduar në Prizren - në drejtimin Gjuhë dhe Letërsi Shqipe.

D. E GREIKOCIT: *Edhe pse punoni administratore në shkollë, ju keni mbaruar studimet bachelor për gjuhë shqipe dhe letërsi. A mund të na thoni se kur keni filluar të punoni për herë të parë në procesin edukativo-arsimor?*

S. KRASNIQI: Pak ditë më parë i kam mbushur pesëmbëdhjetëvjet përvojë pune.

D. E GREIKOCIT: *A mund të na tregoni se cilat janë detyrat dhe përgjegjësitë e administratorit të shkollës?*

S. KRASNIQI: Detyrë kryesore është ana administrative, si dhe menaxhimi i financave.

D. E GREIKOCIT: *Na tregoni sinjerisht për Ju a është më mirë të ushtroni këtë profesion apo të ktheheshni në procesin mësimor?*

S. KRASNIQI: Edhe pse punën e mësimdhënies e kam bërë me përkushtim dhe dëshirë, nuk do ta ndaja as punën e administratorit. Është një punë atraktive dhe ndjej kënaqësi të madhe në kryerjen e detyrave dhe përgjegjësi ndaj kësaj pozite.

D. E GREIKOCIT: *Meqë një periudhë keni dhënë mësim a mund të veçonit ndonjë moment që ju ka ngjitur në kujtesë?*

S. KRASNIQI: Ka shumë momente që më kanë bërë përshtypje, ngase kam dhënë mësim nëntë vjet dhe çdo herë ka pasur diçka tërheqëse në punën me nxënës. Do të veçoja, sidomos, kur bënim teste me nxënës e rezultatet ishin të larta. Edhe tani kur i takoj ish-nxënësit e mi dhe dëgjoj se kanë arritur të shkollohen në profesione të ndryshme, ndjej një kënaqësi dhe nostalgji të veçantë për kohërat e kaluara.

D. E GREIKOCIT: *A mund të na tregoni se si është koordinimi i punëve mes jush, drejtorit të shkollës, si dhe stafit mësimdhënës?*

S. KRASNIQI: Koordinimi ndërmjet administratorit, drejtorit, stafit të mësimdhënies dhe të stafit të mirëmbajtjes është shumë i kënaqshëm dhe i koordinuar mjaft mirë. Gjithçka shkon sipas rregullave dhe në harmoni të plotë.

D. E GREIKOCIT: *Administratori është autoriteti më i lartë administrativ dhe përgjegjës për mirëfunksionimin financiar të shkollës. Na thoni a po keni vështirësi rreth kësaj?*

S. KRASNIQI: Kam bërë gati shtatë vjet në këtë detyrë dhe nuk kam fare vështirësi. Edhe me numrin e nxënësve qëndrojmë mjaft mirë. Nuk kemi fare probleme financiare, sa i përket shpenzimeve brenda shkollës e sidomos të materialit shpenzues, që është më i kërkuari.

D. E GREIKOCIT: *Administratori është mbikëqyrës i stafit mbështetës të shkollës. Ju lutem na thoni se si shkojnë punët me këtë staf?*

S. KRASNIQI: Në stafin tonë të shkollës ekziston një harmoni e vërtetë. Mendoj që kjo është për t'u lakmuar dhe admiruar nga shkollat e tjera.

D. E GREIKOCIT: *Një periudhë (gati dyvjeçare) kohore keni qenë edhe ushtruese e detyrës së drejtorit. Gjatë asaj kohe keni udhëhequr shkollën me mjaft kompetencë. Na tregoni për sfidat që ju kanë përcjellë gjatë asaj kohe?*

S. KRASNIQI: Me thënë të drejtën në fillim punën e kam marrë me mjaft stres, por aq mirë kam kaluar sa se kam pritur. I gjithë stafi i mësimdhënies dhe stafi i mirëmbajtjes kanë qenë përkrahës në çdo kërkesë. Mund të them se fare nuk kam pasur probleme, përkundrazi, ka qenë një përvojë e kënaqshme dhe e paharruar për mua.

D. E GREIKOCIT: *Meqenëse jeni e kualifikuar për mësimdhënie, a mund të thoni dy-tri fjalë rreth reformave në arsim, trajnimeve të ndryshme, që organizohen me qëllim të perfeksionimit të mësimdhënies. Dihet se mësimdhënësit tanë tashmë po punojnë me kurrikulë të re. A ka vështirësi rreth zbatimit të kurrikulës?*

S. KRASNIQI: Reformat në arsim janë pa dyshim të mirëseardhura, po ashtu edhe trajnimet, ngase ju jepen mësimdhënësve mundësi të shumta për rezultate sa më të larta. Sa i përket mësimdhënies me kurrikulë të re, pa dyshim, që kanë mjaft vështirësi. Mund të them lirisht se problemi kryesor është mungesa e teksteve me kurrikulë të re.

D. E GREIKOCIT: *Kjo bisedë zhvillohet për revistën e shkollës sonë? Çka mendoni për punën e redaksisë së revistës?*

S. KRASNIQI: Mendoj që kanë bërë një punë mjaft të mirë. I përgëzoj për punën që po bëjnë! Ju uroj suksese të mëtejme!

D. E GREIKOCIT: *Për fund cili do të ishte mesazhi juaj?*

S. KRASNIQI: Të punojmë sa më shumë. Nëse punojmë me përkushtim edhe rezultati nuk do të mungojë.

Bisedoi: Fikret RAMAJ

PËRKUJTIM

DO TA KUJTOJMË ME NDER E RESPEKT



Rexhep Canaj

Më 12 prill të këtij viti bëhen një vit, kur u nda nga ne, shoku dhe punëtori i shkollës sonë, Rexhep Canaj.

Rexha, siç e thërrisnim të gjithë u lind në vitin 1956 në fshatin Greikoc. Shkollën fillore e kreu në vendlindje. Në vitet më të vështira të shkollës shqipe (në vitet e 90-ta) punësohet në detyrën e punëtorit ndihmës të shkollës. Këtë detyrë e kreu me nder dhe përgjegjësi, deri në ditët e fundit të jetës së tij. Rexha ishte punëtor i zellshëm, shok i mirë për të gjithë.

Gjithmonë do ta kujtojmë me respekt. Ti do të jesh gjithmonë prezent në zemrat tona. Drejtori, si dhe i gjithë kolektivi i shkollës sonë shpreh ngushëllimet më të

sinqerta për vdekjen e shokut tonë të paharruar, Rexhep Canaj.


U PREFTË NË PAQE SHPIRTI I KËTIJ PUNËTORI TË PALODHUR!

Fikret **RAMAJ**

E S E

INTERNETI

Komunikimi është sferë e jetës së njeriut, që ekziston pothuajse, që prej ekzistimit të vetë jetës. Shumë kohë më parë mjetet e komunikimit kanë qenë letrat, më pas telefoni e tani pjesë e komunikimit bashkëkohor është rrjeti global, që ndryshe e quajmë INTERNET. Sot interneti është bërë mjet shumë i rëndësishëm në jetën e njeriut. Sa me shumë të drejtë mund të themi se shumica e njerëzve nuk mund ta imagjinojnë jetën pa të. Tani jemi në kohën e elektronikës, në kohën e internetit dhe në kohën e informacionit pafund të civilizimit. Interneti është botë eksploruese, botë e gjerë e informacionit. Ai është lajmi i fundit, ku secili gjen informacionet më të fundit nga vendi ynë dhe nga e gjithë bota. Njerëzit nëpërmjet rrjeteve sociale kanë mundësi të kontaktojnë dhe të shkëmbejnë informacione nga çdo cep i botës. Ai i bënë lidhjet personale më të forta, duke mbetur në kontakt me ta. Së bashku, me teknologjinë e informacionit, kanë ardhur edhe shumë elemente pozitive, por duhet të jemi të kujdesshëm për çmimin që po paguajmë, sepse sa më shumë kohë kalojmë në të, aq më shumë të varur po bëhemi prej tij. Shoqëria duhet të ndërgjegjësohet lidhur me efektet e dëmshme të internetit, mjetëve sociale dhe lojërave kompjuterike në trurin e njeriut. Ai mund të dëmtojë aftësinë tonë për të



mësuar e lojërat kompjuterike mund të na bëjnë më jo të qetë e agresiv në jetën e përditshme. Ato nxisin dhunë dhe krijojnë personalitet agresiv. Përdorimi i internetit duhet të jetë i kontrolluar, veçanërisht për moshat e vogla. Prindërit dhe mësimdhënësit duhet t'i pajisin fëmijët me një edukatë mbi shpenzimin e mençur të kohës, sepse kalimi i kohës karshi kompjuterit shkakton pasivitet tek fëmijët dhe te të rinjtë. Për më tepër kjo rrit edhe stresin, të cilin e përfetojnë fëmijët më vonë. Harxhimi i kohës në internet i largon fëmijët nga aktivitetet e ndryshme sportive, lojërat grupore etj. Fëmijët që i ekspozohen lojërave me skena dhune, janë të prirë drejt agresionit, frikës dhe panikut dhe në përgjithësi janë të nevrikosur dhe më temperament, duke e konsideruar dhunën si diçka të zakonshme. Prandaj, mbetet përgjegjësi e prindërve, që t'i udhëzojnë fëmijët në përdorimin e drejtë të internetit.

Punuar nga nxënësit e klasës V/1

Ajet Kicaj, Njomza Tafaj, Florent Zenelaj dhe Ledion Selimaj

-Për nder të 13 Qershorit – Ditës së Çlirimit të Therandës u organizua një turne në volejboll për femra në nivel komunal. Në këtë turne, me sukses mori pjesë edhe shkolla jonë, e cila në fund zuri vendin e dytë. Në finale u ndeshëm me shkollën “Migjeni” të Gjinocit. Nxënësit që përfaqësuan shkollën tonë në këtë eveniment sportiv ishin: Eglantina Kurtishaj, Latife Lushaj, Kaltrina Shahinaj, Arbnora Haxhaj, Erijona Haxhaj, Aurora Beqiraj dhe Fëllanza Beqiraj. Këtë sukses, nxënësit tanë e arritën me ndihmën e arsimtares së edukatës fizike, **Bukurie Asllanaj**.

-Në përfundim të vitit shkollor 2016/2017, nxënësit e shkollës sonë, në testin e arritshmërisë në nivel komunal u renditën në vendin e dytë, duke arritur një sukses të shkëlqyeshëm (74%).

-Me rastin e kremtimit të 28 Nëntorit – Ditës së Flamurit kombëtar, në shkollën tonë u mbajt një program i begatë kulturor e artistik. Përgatitjen e programit e bënë arsimtarët e gjuhës shqipe dhe të letërsisë (**Merita Kukaj, Zelië Lushaj dhe Nasuf Krasniqi**), arsimtarja e edukatës muzikore, **Ardhmërie Baraliu**, si dhe nxënësit e shkollës sonë.

-Për nder të 17 shkurtit – dhjetëvjetorit të pavarësisë së Kosovës, nxënësit e shkollës sonë përgatitën një program të pasur me poezi, këngë e valle. Kujdesin që programi të jetë sa më i mirë dhe më i begatë e bartën arsimtarët e gjuhës shqipe, arsimtarja e edukatës muzikore. U hap edhe një ekspozitë me vizatime të ndryshme. Për ekspozitën u kujdes arsimtari i artit figurativ, **Fahri Kukaj**, bashkë me nxënësit tanë.

-Për nder të 7 Marsit – Ditës së Mësuesit në shkollë u mbajt një orë letrare. Me punimet e tyre u paraqiten nxënësit tanë, duke lexuar para të pranishmëve poezi të ndryshme, me karakter për këtë festë. Për këtë orë letrare u përkujdesën arsimtarët e gjuhës shqipe.

-Mësuesi, **Fikret Ramaj**, u zgjodh mësuesi

më i mirë i shkollës sonë dhe për nder të 7 Marsit – Ditës së Mësuesit u nderua me mirënjohje nga Drejtoria Komunale e Arsimit e Therandës.

-SHFMU “**Dëshmorët e Greikocit**” është përfshirë në procesin e vetëvlerësimit, bazuar në UA 04/2017 për vlerësimin e brendshëm të shkollës. Shkolla jonë ka filluar këtë proces, bazuar në udhëzuesin për vlerësimin e brendshëm të shkollës i nxjerrë nga IPK dhe, po ashtu, i bazuar në programin e trajnimit për vetëvlerësimin të performancës së shkollës. Shkolla jonë ka filluar procesin e vlerësimit të brendshëm konform procedurës dhe hapave kryesorë sipas Udhëzuesit për vlerësimin e brendshëm. Është formuar edhe ekipi për vlerësimin e brendshëm të shkollës: **Muhamet Kicaj, Fikret Ramaj, Sami Baraliu, Haki Beqiraj dhe Besim Halitaj**. Pas një pune tremujore, ekipi me mjaft sukses kurorëzoi këtë punë, duke dalë me raportin final për vlerësimin e brendshëm të shkollës.

-Kolegji “**Mehmet Akif**” në Prizren organizon edhe këtë vit kurse pa pagesë për lëndët: matematikë dhe gjuhë angleze për klasat e pesta dhe të nënta të shkollave shtetërore. Këto kurse do të mbahen çdo të shtunë brenda 22 shkurtit deri më 28 prill. Këto kurse do të organizohen me qëllim që t'i ndihmojë nxënësit në mësimet e tyre. Programi i kurseve do të jetë gjithsej 10 javë. Këto kurse do të mbahen bashkë me nxënësit e kolegjit “**Mehmet Akif**”, ku pas përfundimit të kurseve, nxënësit, të cilët janë të rregullt do të pajisen me certifikata. Nga shkolla jonë këto kurse i ndjekin rreth 36 nxënës.

-Shkollën tonë, në forma të ndryshme e kanë ndihmuar shumë individë. Vlen të potencohet se në këtë vit shkollor u jemi mirënjohës për ndihmë dhe kontribut këtyre personave: **Xhevat e Luljeta Kicaj**, firmës “**Lindi – Metal**”, **Arbër dhe Urim Zmalaj, Jetmir dhe Ganimete Kicaj**. Drejtoria dhe kolektivi i shkollës sonë i falënderon nga zemra për ndihmën e dhënë.

-Lidhja e Pedagogëve të Kulturës Fizike organizon gara komunale në futboll të vogël dhe në voleyboll për femra. Nga 19.3.2018 deri më 23.3.2018 bëhet paraqitja e ekipeve. Më 26.3.2018 do të tërhiqet shorti. Në këto gara do të marrë pjesë edhe shkolla jonë.

-Duhet theksuar se këto ditë, shkolla jonë ka fituar një grant nga Banka Botërore për dixhitalizimin e shkollës. Shkolla jonë doli fitues, edhe përkundër një konkurrence të madhe.

-Kompania Rajonale e Ujësjetllësit "Hidroregjioni Jugor" me seli në Prizren, në bashkëpunim me Drejtorinë e Arsimit në Therandë, do të zhvillojnë aktivitete me nxënës për të shënuar Ditën e Ujit – 22 marsin 2018. Aktiviteti do të zhvillohet me temën: "Natyra

dhe uji" dhe atë:

1. Në shkrimin e esesë, dhe
2. Në punimin figurativ.

Të gjitha shkollat (6-9) do të përfaqësohen me nga 2 nxënës: një nxënës që do të përfaqësojë shkollën në **shkrimin e esesë** dhe një nxënës që do të përfaqësojë shkollën në **punimin figurativ**. Për këto dy aktivitete do të ketë shpërblime: Vendi i parë – 100 euro; vendi i dytë – 50 euro; vendi i tretë – 30 euro.

-Për nder të 5 prillit- Ditës së shkollës dhe Ditës së dëshmorëve, arsimtarja e edukatës fizike, **Bukurie Asllanaj**, në bashkëpunim me drejtorinë e shkollës sonë, do të organizojnë krosin pranveror. Në këtë kros do të marrin pjesë nxënësit, por edhe arsimtarët e shkollës sonë. Për tri vendet e para fituese, do të ketë medalje dhe mirënjohje.

Kronisti i shkollës

E S E

DROGA DHE PËRDORIMI I SAJ

Droga (substancë psikoaktive) është çdo substancë e huaj kimike, që ndryshon funksionimin e një sistemi biologjik.

Shumë substanca mund të shërbejnë si droga, përfshirë qetësuesit e dhembjeve, alkooli, nikotina, kafeina, antibiotikët, drogat narkotike dhe psikoaktive.

Shkenca, e cila studion ndikimin e drogave është Psikofarmakologjia.

Jo të gjitha drogat janë të paligjshme, p.sh.: alkooli, kafeina që gjendet në kafe ose në pijen coca-cola, nikotina që gjendet në cigare

janë teknikisht
d r o g a t ë

ligjshme.

Doza, cilësia dhe lloji i drogës janë karakteristikat kryesore, që duhen mbajtur parasysh nga përdoruesit për të shmangur problemet e ndryshme që mund të shkaktohen.


Drogat mund të pengojnë zhvillimin psikologjik dhe emocional nëse përdoren në mënyrë të pandërgjegjshme, sidomos nga personat akoma në zhvillim (-18). Përdorimi i tyre mund të shkaktojë probleme neurologjike dhe mund të shkaktojë infeksion me hepatit ose HIV dhe sëmundje të tjera.

Shkëndije KICAJ, IX,

DITURIA

Dituria është rruga e dashurisë njerëzore. Të kërkojë dituri është njëllë si të kërkojë dritën e Diellit. Që në barkun e nënës fëmija i ardhshëm lind me një zemër, me dy sy dhe me dy veshë, që të udhëhiqet dhe të mësojë diturinë në këtë jetë. Çdo prind i ka dhënë fëmijës së tyre nxitjen e parë drejt diturisë, që ta kërkojë atë, ta përdorin mendjen e të futet në të gjitha fushat e jetës dhe në çdo kohë të saj. Dituria ecën bashkë me dashurinë! Në qoftëse nuk e dashuron dijen, të rejtat dhe të vjetrat e jetës njerëzore, nuk ke etje për to, është njëllë si të themi se nuk ekziston si qenie njerëzore.

Rita CURRAJ, kl. VII,



17 SHKURTI

Thonë se çdo fillim ka edhe një fund. Pas çdo shiu lind edhe dielli. Pas çdo vuajtjeje do të vijë edhe ditë gëzimi.

Kështu ndodhi edhe me shtetin më të ri në botë - KOSOVËN. Pas shumë vuajtjeve e pas gjithë këtyre viteve pritjeje më në fund erdhi dita e shumëpritur - 17 Shkurti i vitit 2008, ditë, kjo e cila Kosovës i solli rreze të arta dielli, ku lotët e hidhërimit u shndërruan në lot gëzimi. Bora filloi të shkrihej, për t'u zëvendësuar nga lule të kuqe, që simbolizonin gjakun e derdhur nga shumë dëshmorë, gra e fëmijë të pafajshëm. Erdhi momenti i shumëpritur. Ora shënonte 15:49. Zemra filloi të rrihte më ndryshe nga emocionet që kishin kapluar edhe më të vegjëlit. Qetësia kishte mbuluar vendin e lotët ishin ata, të cilët rridhnin pandërprerë. Ishte momenti, kur kryeministri Thaçi me zë të lartë e plot krenari e shpalli Kosovën shtet të pavarur e demokratik. Ëndërrat e kahmotshme të shqiptarëve u bënë realitet. Dëshmorët tani do të pushojnë të qetë, e ne e fëmijët e tyre do ta gëzojmë lirinë që ata e deshtën aq shumë.

**Punuan nx.e klasës V1:
Erlis Kurtishaj & Ermal Kurtishaj**

7 MARS

Muaji Mars është muaj që për kombin tonë sjell festa të shumëfishta dhe të rëndësishme. Një ndër festat që sot e festojmë me shumë dashuri është 7 Marsi. Kjo festë festohet pikërisht në këtë ditë, sepse më 7 Mars të vitit 1887 u hap shkolla e parë shqipe e që më parë ishte e ndaluar. Nga ajo kohë filloi zhdukja e analfabetizmit. Lufta kundër pushtuesve tani nuk ishte vetëm me pushkë, por edhe me penë. Në këtë datë të rëndësishme të arsimit shqip kujtohet me respekt puna e sakrifica e mësuesve shqiptarë. Po në Mars të vitit 1981 lëvizja studentore u hodh në një protestë masive, e cila nuk u ndal deri në kurorëzimin e Marsit të vitit 1998, ku u flijua familja Jashari. Aty u shënua fundi i robërisë dhe Kosova i vuri themelet e lirisë. Për mësuesit, të cilët e ruajtën dhe e kultivuan arsimin shqip... Urime 7 Marsi-Dita e Mësuesit!

Dëshmorëve e martirëve që ranë për liri u qoftë lavdi!

**Punuan nx.e klasës V/1:
Jola Curraj & Etleva Beqiraj**

FAMILJA

E si mund të ishte jeta - jetë pa familje? Ajo është diçka e bukur që Zoti na ka dhuruar. Anëtarët e saj janë aq të bashkuar dhe të lidhur me njëri-tjetrin sikur t'i kesh futur në një kuti të vogël.

Familja është vendi ku gjen mbështetje. Do të ishte e kotë të fillonim ta harronim dashurinë për të, sepse duam apo s'duam ajo nuk shqitet nga qenia jonë. Ndodhet në një vend sekret, ku e keqja s'e gjen dot.

Ajo jeton për ty. Nuk të heq nga mendja asnjë sekondë. Të fal çdo gabim. S'të lë të ndihesh i pavlerë, duke të dhënë një dashuri të çmuar.

Pra, familja është e para në jetë, që nuk duhet ta braktisë, përkundrazi bëje të lumtur, sepse është gjëja më e shtrenjtë që kemi.

Shkëndije KICAJ, IX₂

PËR DËSHMORËT

Ka vetëm një rrugë, ku është shkruar historia e lirisë. Ajo rrugë është gjaku i dëshmorëve. Zemra më bëhet mal më shumë se kurrë kur dëgjoj këngë e poezi për dëshmorët e kombit. Do të kalojmë vite e shekuj, por ne kurrë nuk do t'i harrojmë dëshmorët tanë. Ata janë nderi dhe krenaria e popullit shqiptar. Lavdi dëshmorëve të kombit tone! Qoftë i përjetshëm kujtimi për TA!




**Granit
KICAJ,
kl. VIII₁**

ZEMRA DHE ENËT E GJAKUT


Sistemin e organeve të qarkullimit të gjakut e përbëjnë zemra dhe enët e gjakut. Zemra ka për detyrë të pompojë gjakun nëpër trupin tonë.

Zemra është organ muskolor dhe përbëhet nga tri shtresa: shtresa e brendshme-endkardi, e mesme-miokardi dhe e jashtme-perikardi. Me anë të një muri ndahet në anën e majtë dhe të djathtë. Si ana e majtë, ashtu, dhe ana e djathtë e zemrës është e ndarë në dy pjesë: një veshëz (atrium) dhe një barkushe (ventrikul). Gjaku hyn në zemër në veshëza, kurse del prej zemrës nga barkushat.

(a)





(b)




Ndërtimi i zemrës, pamja e jashtme (a) dhe prerja për së gjati (b)

Gjakun e sjellin në zemër venat, kurse nga zemra e largojnë arteriet, pa marrë parasysh a bartin gjak të oksigjenuar apo të reduktuar.

Enët e gjakut janë të shpërndara në tërë trupin e njeriut. Në muret e tyre gjenden mbaresat e sistemit nervor autonom. Në enët e gjakut bëjnë pjesë arteriet, venat dhe kapilarët. Arteria më e madhe është aorta.



Qarkullimi i gjakut nëpër vena



Ndërtimi krahasues i venave dhe i arterieve

Puna e zemrës


Muskuli i zemrës punon, duke u tkurrur dhe shtrirë me alternim veshëzat dhe barkushet. Kur veshëzat janë të tkurrura, barkushet janë të shtrira dhe anasjelltas. Me tkurrjen e veshëzave gjaku kalon në barkushe dhe rikthimin e gjakut prapa, nga barkushat në veshëza e pengojnë valvulet. Në punën e zemrës ndikon edhe sistemi nervor autonom ose vegjetativ. SN simpatike shpejton punën e zemrës, kurse ai parasimpatik e ngadalëson.

Puna e zemrës, gjithashtu, varet edhe nga gjendja fiziologjike e organizmit, pra, nëse ne jemi në gjumë zemra punon më ngadalë, ndërsa kur ne bëjmë ndonjë aktivitet fizik puna e zemrës përshpejtohet.

Tensioni i gjakut dhe pulsi

Dalja e gjakut nga barkusha shkakton një shtypje të caktuar në muret e arterieve, që quhet shtypje apo tension i gjakut. Kur barkushet tkurren rritet shtypja e gjakut (shtypja sistolike), kurse kur ato shtrihen shtypja e gjakut zvogëlohet (shtypja diastolike).

Dallohet qarkullimi i madh i gjakut ose trupor dhe qarkullimi i vogël i gjakut ose mushkëror, të cilët lidhen ndërmjet vete me zemër.



Matja e gjakut


Qarkullimi i gjakut

Në trupin e njeriut gjaku qarkullon në dy rrethe:

1. Qarkullimi i madh i gjakut
2. Qarkullimi i vogël i gjakut.

Qarkullimi i vogël i gjakut, fillon me arterie mushkërore, që çojnë gjakun me CO₂ prej barkushës së djathtë në mushkëri. Nga kjo del se qarkullimi i vogël i gjakut shërben për pastrimin e gjakut në mushkëri (begatimin e tij me oksigjen).

Qarkullimi i madh i gjakut fillon me barkushën e majtë të zemrës, prej nga gjaku i begatuar me oksigjen pompohet në aortë. Aorta pas daljes nga zemra degëzohet në enë më të vogla, deri në kapilarë arteriale, nga ku gjaku u jep



Sistemi i qarkullimit të gjakut fig. (a)

qelizave oksigjen dhe lëndë ushqyese dhe merr prej tyre CO₂ dhe lëndë të panevojshme.

Pasi qarkullojnë dy sisteme të gjakut zemra është e ndarë në dy pjesë, ana e majtë dhe ana e djathtë, ku secila pjesë ka veshëzen dhe barkushen e vet, duke bërë kështu që të mos përziehet "gjaku i pastër" dhe "gjaku i papastër".

Gani KICAJ, arsimtar i biologjisë

GJYSHI IM

Nipin po e gëzon
Mbesën po e qetëson
Me përrallat e tij
Që vetë i krijon.

E bën shaka gjyshen
Ajo vetëm qeshet
Nuk është si gjyshet e tjera
Që në fytyrë të prehet.

Gëzohet e qeshet
Pastaj vjen pranë nesh
Që në grupin tonë
Edhe ajo të marrë pjesë.

Yllza Kurtishaj, kl. I/2

KRENARIA JONË

Sikur mali kur jehonë
Sikur deti kur ushton
Sikur qielli kur gjëmon
Shqipja jonë fluturon.
Fluturon mbi të gjithë
Shqipërinë
Nga Ulqini në Janinë
Nga Kosova në Çamëri
Të gjithë shqiptarët janë kuq e zi.
Një ka qenë dhe një do mbetet
Gjaku i shqipeve kurrë nuk tretet
Vlon si vrull në zemrën tonë
KOSOVË, krenaria jonë.

Eriona Haxhaj, kl. IX/2

VAJZA E DËSHMORIT

Sa shumë të ka pritur
Vite me radhë
Në vend teje mori
Një grusht eshtra të tharë.
Dhuratën që ja premtove
Tash e ka kuptuar
Kishte qenë liria
Që sot është duke e gëzuar.
Tash krenohet me ty
Edhe pse ti s'je
Historia jote
Mbetet gjithmonë me ne.

Rinesa Kicaj, kl. VIII/2

FESTA E NËNËS

8 Marsi ditë e bekuar
Që të gjithë e festojmë
Çdo fëmijë me buqeta në duar
Nënave 8 Marsin ia urojnë.

Nëna është person i veçantë
Të gjithë i lumturon
Kur ajo gjendet pranë meje
Zemrën ma gëzon.

Gëzuar, pra nëna
Me plot dashuri
Marsri është muaj i veçantë
Për mua dhe për çdo fëmijë.

Eden Haxhaj, kl. I/2



ADEM JASHARI

Adem Jashari legjendar
Trim i madh kosovar
Bashkë me Hamzën duke
luftuar
Kosovën për ta çliruar.

Kosova jonë tash je e lirë
E heronjtë i ke të mirë
E dhanë gjakun për liri
Për të shtrenjtën Pavarësi.

Tani do të jetë e lirë
E gjithë shqiptaria
Rroftë Kosova jonë!
Rroftë e gjithë Shqipëria!

Albiona Selimaj, kl. VIII/2

MOLLËKUQJA

Vesha një fustan
Me ngjyrë të kuqe
Të dukem tamam
Si një mollëkuqe.

Mirë u rregullova
Dola te dera
Të pres nuk pritova
Sa të vij pranvera.

Prita sa prita
Pranverën s'e takova
Në shtëpi erdha
Mamit i tregova.

Ishim në ballkon
Mami filloi të qesh
Gjelbërimi na tregon
Pranvera është mes
nesh.

*Blinera Selmanaj,
kl. II/1*

ZOGU

Çfarë kërkon, o zog
i vogël
Ti në shtëpinë time
A kërkon ushqim
Ti nga dora ime.

Bëhu shoku im
Të lozim së bashku
Do të jap thërrime
Ty nga dora ime.

Lorieta Kicaj, kl. II/2

MOMENTET E LUMTURA GJITHMONË JANË TË SHKURTRA

Nxënësit e klasave të nënta të shkollës sonë janë para përfundimit të shkollës së mesme të ulët. Redaksia e revistës vendosi që të bëjë një anketë me ta, për t'u njohur më për së afërmi lidhur me dëshirën për të ardhmen e tyre. Ata me kënaqësi pranuan që t'i përgjigjen pyetjes sonë: „Çfarë drejtimi do të merrni në vazhdim të shkollimit?“

EURONA SELIMAJ: Pas mbarimit të klasës së



nëntë secili nga ne do të zgjedh profesionin e tij për të ardhmen. Do të ndjekim ëndrrën tonë, të cilën e kemi menduar gjithnjë, ta arrijmë dhe të jemi të suksesshëm. Ëndrra ime për të ardhmen është të jem një mësuese, e cila do të bëj punën me plot përkushtim, të edukoj nxënësit, të ndihmoj ata për çdo vështirësi. Roli i mësuesit nuk është vetëm të


shpjegojë, mirëpo do të jesh dhe një prind i dytë për ta. Shpresoj dhe unë të jem një mësuese e suksesshme dhe të realizoj ëndrrën time.

SHKËNDIJE KICAJ:

Të marrësh njohuri do të thotë të bëhesh njeri i ditur, përgjegjës, i aftë për të kaluar çdo sfidë. Disa nga këto i mora në shkollën fillore prej mësuesve të parë, të cilëve u jam shumë mirënjohëse. Mirëpo, nuk mbaron me kaq. Pas mbarimit të shkollës fillore duhet të vazhdoj të marr njohuri të reja. Për mua vazhdimi i mëtejshëm i njohurive mendoj të jetë në shkencat e juridikut. Më pëlqen të studioj këto shkencë, sepse është mision në shoqëri. Funkcioni i saj është për t'u treguar qytetarëve se çfarë urdhërojnë njerëzit në pushtet dhe anasjelltas.



RINESA KOKAJ:



Tani jemi në fund të klasës së nëntë. Kaluam shumë momente të bukura dhe të paharrueshme. Secili duhet të zgjedh se çfarë drejtimi të marrë në shkollën e mesme. Unë kam menduar që shkollën e mesme ta përfundoj në gjimnazin „Jeta e Re“. Në të ardhmen preferoj të bëhem juriste dhe shpresoj se do ta arrij qëllimin.


LEONARD LUSHAJ:

Prioriteti im është që, së pari, ta përfundoj me sukses testin e arritshmërisë dhe të regjistrohem në gjimnaz - shkencë natyrore, pasi që kam një sukses të shkëlqyer. Ëndrra ime është të bëhem jurist në të ardhmen. Kjo dëshirë më lindi nga fakti që në vendin tim duhet vendosur rend dhe qetësi, si dhe të dënohen ata që bëjnë krime. Drejtësia të triumfojë e të ketë paqe për secilin banor në vendin tonë.



ALBION HAXHAJ:

Si çdo nxënës edhe unë kam dëshira dhe ëndërra. Dëshira ime është që pasi të përfundoj klasën e nëntë të regjistrohem në shkollën e mjekësisë. Ëndërroj të bëhem mjek. Arsyeja se përse dua të bëhem mjek është, sepse, kam dëshirë që t'i ndihmoj personat e sëmurë. Detyra e mjekut nuk është e lehtë, pasi një mjek kushton jetën e tij në shërbim të pacientëve. Ai lehtëson vuajtjet dhe dhembjet e pacientëve. Shpesh ai duhet ta vizitoj pacientin në orët e hershme, duke e lënë pushimin, gjumin e ndonjëherë edhe ushqimin. Me gjithë këto detyra të vështira unë kam ëndërr që një ditë të ushtroj profesionin e mjekut.



FËLLËNZABEQIRAJ:

Unë pas përfundimit të klasës së nëntë do të vazhdoj shkollën e mesme në Therandë - shkencat shoqërore. Ku pas përfundimit do të vijoj studimet në fakultetin e matematikës, ku më pëlqen shumë si lëndë. Shpresoj që në të ardhmen time të plotësoj synimet e mia me sukses dhe të bëhem një profesoreshë e denjë.



ANKETË ME NXËNËSIT E KLASAVE TË NËNTA


YLLJETA KICAJ: Jemi në prag të përfundimit të klasës së nëntë dhe këto momente më bëjnë të mendoj shumë për kohën e kaluar në shkollë, që nga klasa e parë e deri më tash. Këto momente më sjellin në kokë të gjitha kujtimet e mira dhe të paharrueshme. Mirëpo, shumë shpejt këtyre mendimeve për të kaluarën do t'ua zërë vendin mendimet, vizioni, por, edhe shqetësimet për të ardhmen. Si çdo



bashkëmoshatar imi edhe unë shpejt duhet të vendos për të ardhmen time, gjegjësisht, për drejtimin që do të marr në shkollën e mesme. Edhe pse e ardhmja është e mistershme, dëshira ime është që shkollimin ta vazhdoj në gjimnazin natyror, duke shpresuar se kjo zgjidhje të jetë e duhura për të ardhmen time. Mendoj se me punë dhe përkushtim mund të arrijmë që t'i realizojmë shumë nga qëllimet tona në të ardhmen.

DONIKABEQIRAJ:

Pas përfundimit të shkollës së mesme të ulët synoj që të vazhdoj studimet në gjimnazin e shkencave shoqërore në komunën e Therandës. Po ashtu, pas përfundimit të shkollës së mesme të lartë, synoj që të vazhdoj studimet e gjuhëve të huaja, siç janë: gjuha angleze, gjermane e pse jo edhe gjuha shqipe. Përveç synimit të studimit të gjuhëve të huaja, synoj që të studioj drejtësinë e vendit tonë. Shpresoj që t'i realizoj me sukses synimet e mia!



DRENUSHASSELIMAJ:



Klasa e nëntë ishte një eksperiencë shumë e bukur për mua. Kisha klasën, kujdestarin dhe arsimtarët e mrekullueshëm. Mbaroi shumë shpejt. S'thonë kot çdo gjë e bukur zgjat pak. Edhe kësaj i erdhi fundi. Por, është një fund shumë i mirë, sepse e di se sa jam kënaqur dhe sa bukur kemi kaluar me klasën time. Tani duhet të zgjedh për të ardhmen. Unë kam zgjedhur që të vazhdoj mësimet për shkencë shoqërore. Shpresoj që të kem sukses!



BEHIJE QELAJ:

Momentet e lumtura gjithmonë janë të shkurtra. Kështu mendojnë shumica e njerëzve. Edhe unë kam kaluar momente shumë të mira. Është viti i fundit dhe ja erdhi koha që unë të mendoj për të ardhmen time, e cila shpresoj që do të më hap rrugë të drejta.

Shkollimin do ta vazhdoj në gjimnaz për shkencë shoqërore. E sa për profesionin tim në të ardhmen nuk e kam menduar ende, por shpresoj të jetë profesion, i cili do të më hap rrugët e suksesit.

ERZAKICAJ:

Unë, konkretisht, si çdo njeri kam një ëndërr për të ardhmen. Ëndërra ime duket që s'mund të arrihet, por unë mendoj me pak durim, sakrificë dhe këmbëngulje asgjë nuk është e pamundur në këtë botë. Ëndërra ime që unë kam për të ardhmen është që të bëhem një mjeke e suksesshme që të shpëtoj mijëra jetë. Shpresoj të me plotësohet kjo dëshirë. Unë dua të jem pjesë e shoqërisë së dijes. Nuk mund të them më e mira, por ndër më të mirat. Kjo besoj se më mjafton. Kjo ëndërr shpresoj të më bëhet realitet.



KALTRINAZMALAJ:

Secili profesion i ka bukuritë e saj, por me e rëndësishme është që të jetë me dashuri dhe përkushtim ajo që bëjmë. E ardhmja nuk është vetëm një pjesë në jetën tonë. Atë duhet ta mendojmë gjatë gjithë kohës. Si gjithë të tjerët, edhe unë kam një ëndërr. Në të ardhmen kam



dëshirë që të bëhem mësuese e suksesshme. E di, më duhet punë dhe përkushtim i madh për këtë drejtim, por kam besim në vetvete. Do të bëj çmos për ta realizuar këtë ëndërr, të cilën gjithmonë e kam dashur.

I anketuan: Merita KUKAJ & Elhame ZENELAJ

AMERIKA VERIORE

Amerika Veriore është kontinent, i cili gjendet ndërmjet Oqeanit të Qetë në perëndim dhe, Oqeanit Atlantik në lindje. Në veri, shtrihet prej pjesëve të ftohta polare deri te Kanali i Panamasë, në jug. Përveç pjesëve kontinentale, Amerika Veriore përfshin edhe një numër të madh ishujsh (Grenlanda, Toka e Bafi nos,



Kristofor Kolombo

Njufaundlend etj.) dhe gadishuj, si dhe ishuj më të vegjël në Oqeanin Atlantik dhe të Qetë. Plotësisht ndodhet në hemisferën veriore. Te Gryka Beringut, në pjesën veriperëndimore i afrohet Azisë për vetëm 92 km. Madhësia e Amerikës Veriore me gadishujt dhe ishujt, në pjesët veriore dhe në Amerikën e Mesme përfshin një sipërfaqe prej 24,2 milion km². Ai është kontinenti i tretë me madhësi në Botë.

Në Amerikën Veriore jetojnë afër 530 milionë banorë. Amerika Veriore, Amerika Jugore dhe Australia ende quhen bota e re. Më saktësisht, kah fundi i shek. XV (vitin 1492) në ishujt e Bahamës ka arritur ekspedita e detarit, Kristofor Kolombo. Ai nuk e ka ditur se ka zbuluar kontinent të ri.

Më vonë në brigjet e Amerikës Veriore ka arritur detari, Ameriko Vespuçi. Sipas tij e ka marrë emrin edhe vetë kontinenti – Amerika. Ardhasakët kryesorë dhe kolonizatorët kanë qenë anglezët, francezët, holandezët, spanjollët dhe portugezët.

Më vonë, kolonitë ndërmjet tyre i ndajnë Anglia, Franca dhe Spanja.



Amerigo Vespucci

Nga kolonitë britanike kah fundi i shekullit XVII është formuar SHBA-ja, të cilat koloni janë zgjeruar mbi kolonitë franceze dhe spanjolle. Në veri, nga kolonitë anglosaksone dhe franceze është formuar Kanadaja; në jug në Amerikën e




Anija e Kristofor Kolombos – “Shën Mërija”

Mesme, ku kolonizues ka qenë Spanja, janë formuar më shumë shtete me ndikim politik dhe gjuhësor spanjoll. Pjesa veriore e kontinentit e ka mbajtur ndikimin anglosakson, ndërsa Meksika dhe Amerika e Mesme kanë ngelur nën ndikimin spanjoll.

Besim HALITAJ, arsimtar i gjeografisë





KOPSHTI POETIK



DËSHMORËT

Për liri jetën sakrifiku
Në luftëra jetën dhuruan
Janë trimat e paharruar
Që Kosovën e çliruan.

Me serbët barbarë
Duke u përballur
Lirinë e bardhë
Për ta shfaqur.

Deri në vdekje luftuan
Lirinë na e dhuruan,
Asnjëherë në jetë ata
S'kanë për t'u harruar.

Albina Tafaj, kl. VII/1

LIBRI

Libri im i dashur
Të kam shok përjetë
Me ty shoqërohem
Sa herë që ndihem
vetë.

Kur luaj me shokë
Kudo që shkoj,
Librin e kam në
mendje
Kurrë nuk e harroj.

Çdo ditë pa pritesë
Libri im ty të shfletoj
Sepse nga ti shumë
gjëra
Të mira po i mësoj.

Redon Selimaj, kl. V/1

XHAXHI IM

Vitet po ecin
Ditët shpejt po shkojnë
Malli për ty xhaxhi
çdo herë
E më shumë po shtohet

Unë nuk të njoha
Nuk të pash asnjëherë
Por gjithmonë e pyes
Babin për ty xhaxhi.

Pusho i qetë në paqe xhaxhi
Se unë çdo herë me mall
Do të kujtoj
Dhe asnjëherë s'do të harroj.

Armira Tafaj, kl. IV/2

1 QERSHORI

Një Qershori dita jonë
Zemrat tona na këndojnë
Lart pëllumbat fluturojnë
Me ne paqja përgjithmonë.

KOSOVË

Çohuni vëllezër shqiptarë
Ju o trima atdhetarë
Çohuni se Kosova
Ka pavarësinë
E gëzon lirinë.

Më armiku s'na shkel pragu
Se frikohet mos ringjallet
Adem Jashari
Ju jem për nder që na sollët
lirinë

Dhe jetë të mbarë.

Ti Kosovë atdheu ynë
Shumë të duam
Dhe të vlerësojmë
Se ti je shtet me vlerë
Ke nxjerrë trima përherë.

Ledion Zenelaj, kl. VI/2

17 SHKURTI

Oj Kosovë lulja e zambakut
Shumë ke derdhur lumenj
prej gjaku
Ti me shekuj në histori
Brez pas brezi nën Serbi.

Dridhet toka, ushton qielli
Në Kosovë pavarësia erdhi
17 shkurti ditë kombëtare
I gëzoi zemrat shqiptare.

Gjithë të lumtur ne festojmë
Dhe dëshmorët i nderojmë
Mbarë bota sot e di
Në Kosovë nuk ka robëri.

Sa e shenjtë e sa e çmuar
Për ne është kjo ditë
Sa me mall thërrasim
KOSOVA REPUBLIKË.

Granit Kicaj, kl. VIII/1

DËSHMORËT

Sot Kosova ka lirinë
Dhe feston pavarësinë
Por nga erdhi kjo liri?
Nga dëshmorët që ranë
për atdhe.

Gjaku i tyre ishte derdhur
Për lirinë që sot e kemi
Ne dëshmorët i kujtojmë
Për sakrificat që bënë
nuk i harrojmë.

Sepse ne po festojmë
Për lirinë dhe pavarësinë
Që sollën dëshmorët tanë.

Enkela Qelaj, kl. V/2

DËSHMORËT E RËNË

M'u tërën sytë duke vajtuar
Lava fusha e bjeshka me lot
Nëse më vrasin pa luftuar
Atdheut liri s'mund t'i sjell dot.

Këto fjalë grykës së pushkës
u dëgjuan
Këto fjalë majës së malit jehuan
Këto fjalë vijnë nga mesi i fushës
Që me gjak krijuan lumin.

Një çmim lirie shumë të lartë
S'mund ta paguajë çdo njeri
Pos atij nëna që i fali
Gjak të denjë për liri.

Lavdi qoftë, dëgjohen zëra
Tek pëshpërisin para ushtarit
Zemra mua më bllokohet e tëra
Kur më kujtohet fytyra e barbarit.

I lehtë qoftë dheu i vendit të tij
E lehtë qoftë dhembja për ne
Nëpër dhëmbë pëshpërit: Lavdi!
Loti shndërohet në krenari.

Enisa Lushaj, kl. VI/2

17 SHKURTI

Dhjetë vjet kaluan
Kujtojmë trimat
Që për ne kanë luftuar
Lirinë për ta gëzuar.

17 shkurti ditë e madhe
Pavarësia e Kosovës
Sot festohet,
Me bijtë e vet nënat krenohen.

Sot në këtë ditë të pavarësisë
Kujtojmë trimat e lirisë
Dhe me zemër themi
„Kosova Republikë“

Milazim Lushaj, kl. VII/1

KOSOVË DIELLI IM QË MË NGROH

Kosovë je dielli im që
më ngroh
Je drita e syve të mi
Je hëna që natën ndriçon
Balli yt vetëm rreze lëshon.

Kosovë ti je ëndërra
Që çdo natë më shqetëson.
Ti je toka ime e lashtë
Kosovë dielli im që
më ngroh.

*Alberita Selimaj,
kl. IV/2*

MË PRIT NËNË!

Ti më prit mos u mërzit
Sepse unë do të vij një ditë
Do të vijë po të premtoj
Fort në qafë do të shtrëngoj.

Ti më prit mos u mërzit
Do të shtrëngoj natë e ditë
Ti më prit, duro edhe pak
Se takohemi s'do të jetë larg.

Rina Kurtishaj, kl. III/1

7 DHE 8 MARS

Janë dy festa të bukura
Njëra e mësueses e tjera
e nënës

Të dyja i dua
Si drita e hënës.

I dua, aq shumë i dua
Se të dyjat më mësojnë
Mua ashtu si nëna
Mësuesja është prindi
i dytë për mua.

Rabie Haxhaj, kl. III/2

TË THËRRET KOSOVA O NASER TAFJAJ!

Më thërret gjaku, më thërret
Kosova
Oj nënë loke s'më mban Toka
Thuaj vëllait nuk kam kohë
Terri i zi s'më lë të shoh.

Nuk shoh natën
Nuk shoh ditën
Nuk e shoh djalin
Se sa është rritur.

Mos ma lini djalin të qaj
Se nënë e babë janë në vaj
Por disi më e mashtro
Thuaj në betejë babi ka shku.

Lavdi të qoftë o Naser trimi!
Se për Kosovë u ndave nga ne
U ndave nga motrat dhe
vëllezërit
Dhe nga bashkëshortja që mbeti
e re.

S'bën të qajmë
S'bën të vajtojmë
S'bën të qesim lot
Për nder të trimit
Të qëndrojmë të fortë.

*Rina Demaj,
kl. VII/2*

Erisa Zenelaj, kl. III/1

Nr. 13 - prill, 2018

ARTI FIGURATIV DHE MODERN


Arti është proces apo produkt i rregullimit të elementeve simbolike kompozicionale figurative për të tërhequr vëmendjen e shqisave apo emocioneve. Arti përfshinë një gamë të gjerë të aktiviteteve, krijimeve dhe mënyra të shprehjes njerëzore, përfshirë muzikën, filmin, vizatimin, skulpturën, grafikën, dizajnin dhe pikturën.

Arti figurativ është prodhim i kreativitetit shpirtëror të njeriut prej parahistorisë e deri më sot. Veprat figurative janë dëshmitare për zhvillimin e mendimit dhe civilizimit njerëzor. Veprat për ne paraqesin pasuri shpirtërore të pakontestueshme kreative.

Arti figurativ paraqitet me vepra, të cilat realizohen me materiale të llojllojshme në hapësirë dydimensionale dhe tredimensionale.

Arti figurativ është pasuri e civilizimit të njerëzimit dhe kreativitetit shpirtëror.

Termi art figurativ është përdorur, veçanërisht, që nga ardhja e artit abstrakt për t'iu referuar artistëve, që mbajnë aspektet e botës reale, si lëndë e tyre, edhe pse në kuptim të përgjithshëm figurativ, po ashtu, zbatohet në mënyrë retrospektive në të gjithë artin para artit abstrakt.



Ibrahim Kodra

Arti figurativ modern mund të shihet si i dallueshëm nga realizmi modern. Në fakt, arti figurativ modern është pak a shumë identik me rrymën e përgjithshme të ekspresionizmit, që mund të gjurmohet përmes shekullit të njëzet dhe më pas.

Arti figurativ është art vizuel, veprat e të cilit i perceptojmë dhe i përgjigjemi me anë të të parit dhe me anë të të prekurit.

Arti figurativ shprehet me anë të gjuhës së artit figurativ, d.m.th. me anë të elementeve

dhe të parimeve figurative. Vija është mjeti kryesor për shprehje figurative në vizatim me një ose më me shumë ngjyra.

Vizatohet në teknika të ndryshme dhe me materiale të llojllojshme me të cilat mund të përpunohet vizatimi. Duke përdorur llojllojshmërinë e materialeve, krijohet mundësia që të fitohen lloje të ndryshme të vijave me bukuri specifike. Në mësimin nga arti figurativ vizatohet me laps, thëngjill, shkumsa të llojllojshëm, pastel të thatë, pastel të yndyrshëm, tush, bajc, si dhe me ngjyra tempere dhe akuarel.

Si fushë më vete, arti figurativ, në krijimin e veprave artistike me mënyra të ndryshme, si dhe me materiale të ndryshme paraqitet me harmonizimin, baraspeshën, hapësirën, me botën e brendshme shpirtërore, estetike, imagjinate, si dhe aspektin emocional, duke mos anashkaluar: trajtat, vijat, ngjyrat, raportin dritëhije, si dhe kontrastin.

Nëse nuk i ka të gjitha këto të lartpërmendurat në një vepër artistike, atëherë nuk mund të themi se ka kreativitet apo është artistike.

Që nga agimi i kohës, njerëzit kanë bërë art për të shprehur formën njerëzore. Këto kategori festojnë arritjet e disa prej artistëve figurues më të mëdhenj të botës, të së kaluarës dhe të së tashmes. Sfera e artit figurativ është aq e gjerë sa ne e kemi

ndarë në tema, duke përfshirë aktet, valle dhe larva. Ju, gjithashtu, mund të eksploroni se si artistët nga rajone të ndryshme anembanë botës kanë përshkruar figurën.

Një kategori e përgjithshme për veprat e artit, që përfaqësojnë materiale të njohura në botën e dukshme, në krahasim me artin abstrakt. Shumëllojshmëria e qasjeve në artin figurativ është shumë e madhe dhe, pothuajse, aq e ndryshme sa historia e vetë artit. Në pikturë, figurimi varion nga fotorealizmi (si ai i Chuck Close) në një fund të spektrit, deri gati abstrakt (si Kubizmi Analitik i Pablo Picasso) në tjetrin. Për pjesën më të madhe të shekullit të 20-të, piktura figurative u injorua, kryesisht, nga avantgarda perëndimore.

Kubizmi – arti modern abstrakt

Përveç impresionizmit e ekspresionizmit në pikturë njihet edhe kubizmi. Kubizmi, së pari, u paraqit në fund të shekullit XIX nga artisti francez, Paul Sezan (1839-1906). Ky artist, në pikturat e tij i shndërronte çdo gjë të natyrës në formë gjeometrike. Ky stil i tij i veçantë e bënte atë të jetë me një stili të ri në pikturë që u quajt kubizëm. Ky stil i ri filloi të paraqitet më 1906 nga dy artistë të shquar nga Gjorgj Braque- artisti francez dhe Pablo Pikaso - artisti spanjoll. Ata u takuan më 1907 dhe punuan ngushtë së bashku derisa shpërtheu Lufta e Parë Botërore. Pikaso dhe Braque ishin eksponentët më të mëdhenj të këtij stili dhe eksplorues të mëdhenj në gjetjen e mënyrave të reja, për të shprehur hapësirë dhe për të formuar një pikturë. Ata ishin të ndikuar nga Paul Cezanne, një artist i artit afrikan fisnor. Faza e parë, që ata punuan përkrah njëri-tjetrit në periudhën 1906-1909, që mund të quhet parakubizëm, ku pas kësaj, filluan të punojnë së bashku për të promovuar pikëpamjet e tyre mbi atë që u quajt më vonë kubizëm analitik rreth vjeshtës 1909 dhe dimrit 1911-1912. Faza e dytë e kubizmit, e cila fillon nga rreth 1913, u quajt kubizëm sintetik. Këto kryevepra ishin të përbërë nga pjesë të dallueshme mbivendosur, pikturuar ose ngjitur shpesh mbi kanavacë dhe janë karakterizuar nga ngjyrat më të ndritshme shumë. Megjithatë, shumë artistë të tjerë që mendonin për veten e tyre, duke u zhvendosur në drejtime të ndryshme shumë të Picasso dhe Braque, i cili nga ana e tyre edhe shkuan nëpër disa faza të dallueshme para 1920. Artistë më të njohur ishin: Paul Sezan, Gjorgj Barque, Fernand Leger, Pablo Pikaso, Juan Gris, Henri Laurem, Henri Matis, Albert Gleiz, Francis Picabia etj.

Kubizmi ishte rrymë vërtet revolucionare e artit modern, zhvilluar nga Pablo Picasso dhe Georges Braques. Ishte rryma e parë e artit abstrakt, që u zhvillua në fillim të shekullit të XX, si përgjigje ndaj botës që po ndryshonte me shpejtësi të madhe. Kubizmi ishte një tentativë e artistëve, për të gjallëruar traditat e vjetëruara të artit perëndimor, të cilave u kishte kaluar koha. Kubistët sfiduan format konvencionale si perspektiva, e cila ka qenë rregull që në Rilindje. Qëllimi ishte të zhvillohej një "mënyrë e re e të parit" të gjërave, e cila do reflektonte kohën moderne.

Ndër ta, si artist kubist shqiptar, që është marrë me vepra të ndryshme moderne është piktori ynë i mirënjohur, Ibrahim Kodra.

Kodra u lind në Ishëm-Durrës më 22 prill të vitit 1918. Jeta e tij në Tiranë në konviktin e shkollës "Naim Frashëri", ndërpritet si 20- vjeçar. Më 1938 largohet nga Shqipëria përgjithmonë në një bursë studimi nga Oborri Mbretëror për në Akademinë e Arteve të Bukura në Romë. Ai e lëshon Romën dhe përfundon në Milano, në Akademinë e Arteve të Bukura të Brerës. Ai ekspozon në Romë, Milano, Venecia, Paris, Beograd, Nju Jork.

Fahri KUKAJ, prof. i artit figurativ



Pablo Picasso

VARËSIA NGA INTERNETIT TE FËMIJËT DHE TEK ADOLESHENTËT



Varësia prej internetit është një çrregullim psikologjik, i manifestuar si një dëshirë obsesive për të kaluar kohën në internet. Personi kalon shumë kohë në aktivitetet e lidhura me përmbajtjen e internetit, duke neglizhuar aktivitetet e zakonshme, si: shoqërimi, detyrimet e biznesit, të mësuarit, punët e brendshme etj. Ka vështirësi në ndërprerjen e aktiviteteve të internetit edhe kur vetë e sheh se është koha për të. Varësia e internetit është një temë që diskutohet gjerësisht në qarqet shkencore dhe mediat, por statusi i saj ende nuk është jozyrtar: nuk mbulohet nga klasifikimi zyrtar i çrregullimeve psikologjike, d.m.th. udhëzues diagnostik dhe statistikor për çrregullime mendore.

Shumë prindër sot janë të shqetësuar se fëmijët e tyre shpenzojnë shumë kohë në internet. Megjithatë, Instituti Kombëtar i Shëndetësisë i Bibliotekës Kombëtare të Mjekësisë (NIH) raporton se „koha e ekranit“ është një problem i përgjithshëm.

Çka është koha e ekranit?

Ajo ishte çdo kohë e kaluar përpara çdo ekrani dixhital të çdo lloji. Kjo përfshinë TV, video- lojërat, pajisje digjitale të dorës dhe, natyrisht, kompjutera.

Studimi Common Sense Media tregoi se fëmijët e moshës 8-18 vjeç shpenzojnë rreth 8 orë në ditë në internet!

Si dhe varësia nga droga dhe alkooli, interneti u ofron fëmijëve dhe adoleshentëve një mënyrë për të shmangur ndjenjat e dhembshme ose problemet me të cilat ato janë të garantuara. Ata sakrifikojnë orë të gjumit për të kaluar kohën në internet dhe për t'u tërhequr nga familja dhe miqtë, në mënyrë, që të ikin në një botë të rehatshme online, që ata krijuan dhe formuan.

Efektet negative të varësisë së internetit

Ankthi, trishtimi dhe depresioni: Adoleshentët që kalojnë pjesën më të madhe të kohës në një botë virtuale, gradualisht, tërhiqen nga bota reale dhe fillojnë të jetojnë në botën e fantazisë. Pas një pierudhe të caktuar, ata bëhen të varur nga interneti për t'u ndier

më optimistë. Dhe, kur nuk janë në gjendje të hyjnë në internet, ata përjetojnë ankth, trishtim dhe depresion.

Mungesa e gjumit: Shumica e adoleshentëve tani kanë telefona të mençur ose tableta, të cilat mbajnë me vete ku shkojnë, madje edhe në shtrat. Ata, gjithashtu, përdorin këto pajisje për t'u lidhur me internetin para se të shkojnë për të fjetur. Ndërsa, adoleshentët normalë mund të shkyqen pas një kohe, përdoruesit e internetit të varur mbajnë kontrollën gjatë gjithë ditës. Si rezultat ata kanë probleme me gjumin: të tilla si gjumi i vonuar, gjumi i pamjaftueshëm ose i shqetësuar dhe më vonë zgjohen. Ky privim (çrregullim) i gjumit mund të përkeqësojë ose të rrisë simptomat e ankthit dhe depresionit.

Ndryshimi i disponimit : Përdoruesit e internetit përdorin internetin për të reduktuar stresin dhe për të rritur disponimin. Ata ndjehen të lumtur ose euforik, kur janë të lidhur në internet. Megjithatë, nëse ata duhet të ndalojnë përdorimin e internetit ose nuk janë në gjendje t'i qasen bëhen të errët, të irrituar dhe të zemëruar.

Çfarë mund të bëjnë prindërit

Është shumë e rëndësishme që të dy prindërit të përfaqësojnë një front unik. Prindërit duhet ta kuptojnë seriozisht problemin dhe duhet të bien dakord për një qëllim të përbashkët. Flisni për situatën së bashku, nëse nuk e bëni, fëmija juaj do të apelojë të një prind më i emocionuar , më tolerant, më i mëshirshëm dhe do të bëjë ndarje mes jush. Natyrisht, para bisedës me fëmijën, prindërit, duhet të mendojnë se çfarë të thonë dhe të përgatiten për një përgjigje të mundshme emocionale nga fëmija. Fëmija, i cili është i varur nga interneti ose është duke u bërë i varur do të ndjehet i prekshëm, vetëm në mendimin për të kufizuar kohën në internet. Një prind duhet të jetë i përgatitur për nxjerrjen emocionale të akuzave të ekspozuara, që janë të shpikura për ta bërë prindin të ndjehet fajtor ose joadekuat. Është e rëndësishme që ju të mos reagoni ndaj emocioneve. Konfirmimi ndjenjat e fëmijës suaj, por qëndroni të përqendruar në temën e përdorimit të tij ose të saj në internet.

Hashim KUKAJ, arsimtar i teknologjisë

	F	J	A	L	Ë	K	R	Y	Q	I										
	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20
1																				
2																				
3																				
4																				
5																				
6																				
7																				
8																				
9																				
10																				
11																				
12																				
13																				
14																				
15																				
16																				
17																				

HORIZONTALISHT:

1.Një dëshmor yni- farkues i arit- lisat e gjatë; 2. Veprim sipas foljes arrestoj - ... Konti- banor i Iranit; 3. Gjuhë e familjes ugrofine – lloj pëlhure; 4. Shkruaj ETDA – dy zanore – një bashkëtingëllore – dem – shoqatë zvicerane; 5. Trajtë e shkurtër e përemrit vetor- një përemër vetor – emër femre – Teatri kombëtar i Ukrainës (shkurt)- veta e dytë e foljes kam (njëjësi); 6. Një zanore – republika demokratike – mbeturinë e zjarrit – hesht (huaj)- një lidhëz; 7. Emër femre- vizitë vendit të shenjtë jo në muajin e haxhit- grup muzikor- një pije joalkoolike; 8. IR – SHGZ – mbërthyes rrobash- ajo që përcakton etninë e një populli; 9. Nxënësi ynë i ndjerë- nxënësja jona e ndjerë- T; 10. Dem – epoka – simboli i bariomit – shtyllë horizontale- G- ish-targa e Pejës; 11. Dëshmor yni- ai që shkruan diçka- tokë pune- L; 12.Një zanore – IMU – gjel me pupla të hapura – lloj patikash; 13. Dy bashkëtingëllore – RAA – fytyrë politike (Sulejman)- përemër pronor – një bashkëtingëllore; 14. Mësues yni i ndjerë – një zanore – zanore – njësi rezistence- telefoni – E; 15. IMO – BRH – vegla lufte- simboli kimik i uranit; 16. Riparim- ndal!- tirani; 17. Pjesëtari internacionales – Ushtria Çlirimtare e Kosovës.

VERTIKALISHT:

1.Një dëshmor yni – shko!- rrathë të lidhur metalikë; 2. Erdha – veprime magjike – një shtet; 3. Fjalë e thënë me thumba - dy bashkëtingëllore të njëjta – aktori ynë i ndjerë Pallaska- Uni... (firmë ndërtimi); 4. Veprim sipas të folmes irlandeze – emër mashkulli – oda ekonomike (shkurt) 5. TTA – një bashkëtingëllore- ngris dhe luaj (një fjalë e vetme) - VR; 6. Jo (huaj) – një dëshmor yni – udhëheqësi i Lëvizjes Vetëvendosje! (Kurti); 7.Një dëshmor yni – MA- një bashkëtingëllore – këngëtarja Libohova; 8. RRI- pjesë e syrit – agimi – emri i patriotit Mosi; 9. Mal yni – shtëpi përmirësuese – I; 10. Dhe (huaj) – I – RSK – fije e hollë metali – ose; 11. Llojë patikash- emri i autorit të romanit “Emri i trëndafilut”- ofshamë – RRN; 12. Uran – Ali Asllani (nistoret)- shkenca që studion trupat qiellorë; 13. Elektroindustria (shkurt)- kaliumi – ushqimi i preferuar kinez – ATI; 14. Përputhje precize (pop.) – shkronjë greke – njësia e punës elektrike – lloj sporti – intensitet; 15. Veprim sipas orinetimit turk – bukuroshe; 16. Pa pushtet – pjesë e trupit- përfundim i lojës së shahut; 17. Një dëshmor yni – JMJ – kornizë – IT; 18. Emri i viktimës së Avni Rustemit – një shtet- pjesë e sures së Kuranit – dy zanore; 19. Telegraf – një dëshmor – fosfor-kaliumi – ushtria çlirimtare (shkurt); 20. Një dëshmor yni – mjet për transport.

E përpiloi: Tahir ZENELAJ

FOTO NGA ALBUMI I SHKOLLËS



Ekipi i vajzave- fitues i vendit të dytë në garat komunale në voleyboll



Redon Selimaj, V/1



Laura Tafaj, IX/2



Punëtorët ndihmës të shkollës sonë gjithmonë janë në nivel të detyrës

KËNDI I PARASHKOLLORËVE



Paraqitje e suksesshme e nxënësve parashkollorë



Program festiv për nder të dhjetëvjetorit të Pavarësisë



Fatlumi



Lorena



Egzona



**BOTIMIN E KËTIJ NUMRI E SPONSORIZOI SHOQATA "GREIKOCI"
ME SELI NË OSSINGEN - ZVICËR**